



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 138/2025
Datë: 03/11/2025

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-68, pjesa IV, neni 81, si dhe neni 70, Rregullores për Prokurim Publik me nr. 001/2022, mbi aktivitetin e menaxhimit të Kontratës, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

Z. Esad Veliu, Zyrtar i Lartë për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në Departamentin për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit, caktohet mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe për mbikëqyrjen e realizuar të obligimeve dhe detyrave kontraktuese të specifikuara në kontratën me titull **"Furnizim dhe shërbime të ndryshme kontraktuese për mbajtjen e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore,,** me numër identifikues të Prokurimit: 21500-25-8124-1-2-1, dhe numër të brendshëm 21500-25-018-121.

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyrë që:
 - 1.1. Mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të kontratës;
 - 1.2. Administrimin e plotë të kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual në kontratë;

1.3. Rishikimin, aprovimin dhe procedimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Anita KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Esad Veliu;
- Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit;
- Divizionit të Prokurimit; dhe
- Arkivit të MD – së.